



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

| | | | |
|------------------------------------------------------------------|--------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranimar / Dorezuar Prenjena / Predato Received / Delivery | 04-03-2021 | 1 | viti god year |
| Organ / Ilesia Organ / Jednica Org. / Unit | In Prot In Prot Prot. no | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMSHK | 971/2021 | | 1/4 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 65/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 65/2021 të datës 08.02.2021 e parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike " *kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.65/2021 e datës 08.02.2021, e parashtruar nga ankuesi**
- II. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që të ndërmarr veprimet e duhura procedurale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për realizimin e pagesës shtesë mbi pagë për kushtet specifike në punë për ankuesin, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.**
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Inspektor i Tregut në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, më datë 08.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 536/2021 të regjistruar me A.nr.65/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për shkak të kushteve specifike të punës, dhe harmonizimin e pagës nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.02.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ndërsa me datë 23.02.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë se bashku me dokumentacionin përcjellës fq. 1/39.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 536/2021 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 8251 të datës 04.11.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të MTI-së; e-mailin e datës 03.09.2020 nga I.S pre L.H, e-mailin e datës 03.06.2020 nga L.S të A.D etj, e-mailin e datës 28.05.2020 nga A.D të I.L etj. Kërkesën me nr. Protokollit 5865 te datës 03.09.2020; kërkesën e datës 04.09.2020, Vendimin e datës 04.09.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Akt Emërimit e datës 21.09.2018; Përshkrimin e Detyrave të Punës se ankuesit; Kërkesën me nr. Protokollit 4867 të datës 13.08.2020, Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 787 të datës 23.02.2021, Listën e pagave; kërkesën e datës 23.02.2018 për shpalljen e konkursit; Autorizimin për Publikim të konkursit të datës 11.04.2018 të Ministrisë së Administratës Publike; e-mailin i datës 22.09.2020; e-maili i datës 18.08.2020; kërkesën e datës 25.09.2020;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka administruar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga _____ është *pjesërisht e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht në bazë të Akt Emërimit të datës 21.09.2018, Kolegji vërën se ankuesi mbanë pozitën e punës Inspektor i Tregut, Siguria e Produkteve në Departamentin e Inspektoratit të Tregut pran Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Me Vendimin Nr.Protokollit 5877 te datës 04.09.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (tutje MTI), është aprovuar kërkesa e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), ndërsa me Vendimin me numër protokollit 8251 të datës 04.11.2020 është shfuqizuar Vendimi Nr. Protokollit 5877 i datës 04.09.2020.

Ankuesi ka parashtruar ankesë kundër mos zbatimit të Vendimit me numër protokollit 5877 të datës 04.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MTI për harmonizim të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8) dhe kundër mosveprimit në realizimin e shtesës në pagë për shkak të kushteve specifike në punë siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut. Propozon që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të obligoj MTI-në për zbatimin e Vendimit me numër protokollit 5877 të datës 04.09.2020 duke bërë harmonizimin e koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8) si dhe te njoh te drejtën e rimbursimit në formë retroaktive nga data 21.09.2018 si dhe ti njihet e drejta e shtesës mbi pagën bazë dhe atë në formë retroaktive nga data 21.09.2018 e deri në zbatimin e këtij vendimi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për shtesën në pagë për shkak të kushteve specifike në punë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke analizuar legjislacionin në fuqi ka konstatuar se dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, përkatësisht neni 10.A paragrafi 1 përcakton se: *"Inspektorëve të tregut i njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit të punës"*, andaj, si rrjedhojë Kolegji vlerëson se ankuesit, respektivisht Inspektorëve të Tregut, sipas dispozitave të ligjit të veçantë, iu njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë, mirëpo duke u bazuar në

paragrafin 2 të këtij neni ku thuhet se: *Shtesat sipas paragrafit 1. të këtij neni do të bëhet konform Ligjit përkatës për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit përkatës për pagat e nëpunësve civil, Kolegji konstaton se realizimi i shtesës për kushte specifike të punës për ankuesin mund të bëhet vetëm pas aprovimit nga institucionet përgjegjëse respektivisht Ministria përgjegjëse për Administratë Publike, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 16 paragrafi 1, ku përcaktohet se: ... institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civilë, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 7 paragrafi 3 ku përcaktohet se ... për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta, institucioni duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike kërkesën që përmban: 3.1 arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte specifike të punës për pozitën (at) përkatëse; 3.2 listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civilë për çdo pozitë; 3.3 detajet, sipas të cilave, secila pozitë përkatëse pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut; 3.4 koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushte specifike të punës.*

Andaj, pas analizimit të bazës ligjore dhe konstatimit se me dispozitat e ligjit të veçantë ankuesit i është njohur e drejta në shtesë për kushte specifike në punë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet të ndërmarr veprimet e duhura ligjore dhe procedurale ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe dispozitat e nenit 7 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, e mbi këtë bazë është vendosur për aprovim të pjesshëm të ankesës A.nr.65/2021 të datës 08.02.2021 dhe detyrimin e organit punëdhënës për veprim ashtu siç përcaktohet në pikë II të diapozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës për kushte specifike të punës në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 21.09.2018, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Ligji Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, është publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 10.05.2013, ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune me datë 21.02.2018 ndërsa ka parashtruar ankesë me datë 08.02.2021, Andaj, ankesa lidhur me këtë pretendimin ankimor është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me nenin 127 ku përcaktohet se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit për mos zbatim të Vendimit me numër protokollit 5877 të datës 04.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për harmonizimin e koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8), Kolegji po ashtu ka konstatuar se ankesa lidhur me këtë pretendim ankimor është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht, Vendimi me numër protokollit 5877 është nxjerrë me datë 04.09.2020 i anuluar me Vendimin më numër protokollit 8251 të datës 04.11.2020, ndërsa ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është ushtruar me datë 08.02.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në këto rrethana si dhe vlerësimin të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegji.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A. Nr. 65/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ - DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

